

VENDIM
Nr.484, datë 17.7.2006

PËR DHËNIE LICENCE
PËR TELEVISIONIN VENDOR PRIVAT “DURRËSI”
SUBJEKTIT JURIDIK: SHOQËRIA “TV DURRËSI” SHPK

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, rregullores “Për licencimin e operatorëve privatë për transmetim RTV analogjik tokësor në nivel vendor”, të miratuar me vendimin nr.355, pika 1, datë 29.8.2005 të KKRT-së, të vendimit nr.474, datë 29.06.2006 të KKRT-së “Mbi licencën e subjektit televiziv vendor privat TV Durrësi”, si dhe rregullores “Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, të miratuar me vendimin nr.375, datë 30.11.2005 të KKRT-së, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. T’i japë subjektit juridik, shoqërisë “TV Durrësi” sh.p.k. licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv vendor privat, në fushën e transmetimeve televizive analogjike tokësore, për një periudhë prej 5 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence, për të mbuluar me sinjal qytetet Tiranë dhe Durrës.

2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Halil Lalaj